

UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
ISA BOLETINI
REKTORATI

Pranuar me dt 16.09.2019			
Njësia org	Numer	Nr ekzempl	Vlera
	1661		

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

SHËRBIMIT GJEOLGJIK TË KOSOVËS

dhe

FAKULTETIT TË GJEOSHKENCAVE

UNIVERISTETI I MITROVICËS

“ISA BOLETINI”

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji Nr. 04/L-232 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës i përfaqësuar nga z. Fidaim Sahiti- Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, dhe Fakulteti i Gjeoshkencave i përfaqësuar nga Prof. Dr. Naser Peci- Dekan i Fakultetit të Gjeoshkencave, pajtohen si në vijim:

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshje bashkëpunimi të lidhur ndërmjet Shërbimit Gjeologjik të Kosovës dhe Fakultetit të Gjeoshkencave, është shfrytëzimi i ndërsjellët i pajisjeve laboratorike të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës dhe Fakultetit të Gjeoshkencave, organizimi i konferencave të ndryshme shkencore si dhe ngritja profesionale e stafit përkatës.

Neni 2 **Pajisjet laboratorike**

1. Pajisjet laboratorike që posedon Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, dhe të cilat janë të vendosura në ndërtesën e Fakultetit të Gjeoshkencave, mund të shfrytëzohen vetëm për qëllime studimore-shkencore (mbajtjen e orëve praktike për studentet) nga stafi akademi i Fakultetit të Gjeoshkencave.
2. Përrjashtimisht, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, për shkak të specifikave, ndjeshmërisë së punës dhe kostos së lartë të mirëmbajtjes dhe riparimit, mund të mos jep qasje në shfrytëzimin e ndonjëres nga pajisjet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Pajisjet laboratorike të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, shfrytëzohen sipas orarit të përcaktuar nga Dekani i Fakultetit të Gjeoshkencave, i cili miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës.
4. Orari i shfrytëzimit të pajisjeve laboratorike të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, bëhet për afate semestrale, sipas Shtojcës 1 të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
5. Orari i shfrytëzimit të pajisjeve laboratorike të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, i dorëzohet stafit përkatës të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës dhe Fakultetit të Gjeoshkencave.
6. Gjatë shfrytëzimit të pajisjeve laboratorike të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, duhet patjetër të jenë prezent nëpunësit përkatës të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës.
7. Pajisjet laboratorike të Fakultetit të Gjeoshkencave, mund të shfrytëzohen nga nëpunësit e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, pas aprovimit të kërkesës nga Dekani i Fakultetit të Gjeoshkencave.

8. Kërkesa për Shfrytëzimin e pajisjeve laboratorike të Fakultetit të Gjeoshkencave, bëhet nga nëpunësi përkatës pas aprovimit nga Udhëheqësi i Departamentit përkatës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, dhe e cila duhet të përmbaj qëllimin e shfrytëzimit të pajisjes përkatëse, si dhe periudhën e shfrytëzimit.

9. Fakulteti i Gjeoshkencave është i obliguar dhe mban përgjegjësi për sigurimin fizik të pajisjeve, si dhe siguron infrastrukturën e nevojshme, përfshirë energjinë elektrike, ujin dhe ngrohjen për funksionimin e tyre.

10. Sigurimi apo kompensimi i materialit shpenzues për përdorimin e pajisjeve të përcaktuara në këtë marrëveshje, bëhet nga pala e cila përdorë pajisjen përkatëse.

Neni 3

Organizimi i konferencave shkencore dhe ngritja profesionale

1. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës dhe Fakulteti i Gjeoshkencave, bazuar në legjislacionin në fuqi, si dhe varësisht nga mundësit financiare, organizojnë konferenca të përbashkëta shkencore nga fushëveprimi i tyre.

2. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës dhe Fakulteti i Gjeoshkencave, varësisht nga mundësit financiare, organizojnë trajnime profesionale me qëllim të ngritjes profesionale të stafit respektiv.

3. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës dhe Fakulteti i Gjeoshkencave, me qëllim të ngritjes profesionale, varësisht nga mundësit financiare, bashkëpunojnë dhe marrin pjesë bashkërisht në konferenca dhe trajnime profesionale nga fushëveprimi i tyre.

Neni 4

Mbikëqyrja e zbatimit

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës dhe Dekani i Fakultetit të Gjeoshkencave, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 5

Hyrja në fuqi


Kjo marrëveshje bashkëpunimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe mund të ndërpritet me njoftimin paraprak nga cilado palë.

Eidaim Sahiti

Drejtor i Përgjithshëm/SHGJK

Prof. Dr. Naser Peçi

Dekan i FGJ/UMIB



Mitrovicë, 16.10.2019